



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:230079

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05497666

C.nr.254/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B... me seli në Prishtinë, rruga ... kundër të paditurit J.G nga Vushtrria, rruga ..., me objekt kontesti Rimbursim dëmi, me vlerë të kontestit 1, 220.00 euro, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 14.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia C.nr. 254/18 e datës 04.06.2018, e paditëses B... me seli në Prishtinë, rruga ... kundër të paditurit J.G nga Vushtrria, rruga ..., me objekt kontesti Rimbursim dëmi.

A r s y e t i m

Paditësja B... me seli në Prishtinë, rruga ..., në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit J.G nga Vushtrria, rruga ..., me bazë juridike-Rimbursim dëmi me vlerë të kontestit 1, 220.00 euro.

Në seancën përgatitore të mbajtur me datë 25.03.2024, nuk ka prezantuar paditësja dhe mungesën nuk e ka arsyetuar edhe përkundër thirrjes së rregullt siç konstatohet nga fletëkthesa e datës 06.03.2024, po ashtu nuk ka prezantuar i padituri J.G, për të cilin në bazë të fletëkthesës është konstatuar se thirrjen e ka pranuar me rregull me datë 27.02.2024, por mungesën nuk e ka arsyetuar.

Marr parasysh faktin se në seancë nuk ka prezantuar paditësja dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata bazuar në nenin 409 par.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.254/18, me datë 25.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.